



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME XHENERIKE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

M2-III-22

Tiranë, 2022

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimit

² Korniza Evropiane e kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime xhenerike			Kodi M2-III-22
	Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional në profilin “Shërbime xhenerike”, Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve xhenerike në automjete si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
8Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin mësimor “Shërbime xhenerike” Niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para në arsimin profesional, drejtimi “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. - mund të pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë e tyre. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime xhenerike”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me certifikatën profesionale dhe suplementin e certifikatës profesionale të nivelit të punonjësit të kualifikuar në këtë profil, të cilat njihen në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t`i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve të mjeteve të ndryshme të transportit, në pika servisi të mjeteve të ndryshme të transportit, të mekanikës bujqësore, të shitjes së pjesëve të ndërrimit, si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në këtë drejtim.</p> <p>Me përfundimin e arsimimit të profilit “Shërbime xhenerike”, niveli III-të në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti” dhe fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	M-II-02-11, M2-III-18			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT:

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Shërbime xhenerike” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet xhenerike

- Të tregojë rëndësinë e shërbimeve xhenerike;
- Të klasifikojë llojet e shërbimeve xhenerike;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e një servisi për shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë organizimin dhe ndarjen e punës në një servis për shërbimet xhenerike;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit me teknikët e grupet e tjera të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit dhe monitorimit të veprimtarisë në shërbime xhenerike;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kontrollit për gatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë procedurat për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë teknikat për vendosjen e mjetit në vendin e kontrollit për shërbimet xhenerike;
- Të tregojë radhën e punës dhe fazat e realizimit të punimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit, ndriçimit dhe sistemimit të vendit të punës.

Veglat, pajisjet e punës, instrumentet matëse e kontrolluese dhe makineritë në shërbimet xhenerike

- Të listojë makineritë kryesore që përdoren në shërbimet xhenerike, sipas funksionit të tyre;
- Të listojë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese në një servis për shërbimet xhenerike;
- Të shpjegojë funksionin e veglave, pajisjeve të punës, instrumenteve matëse dhe kontrolluese, sipas manualit të prodhuesit;
- Të shpjegojë përdorimin e veglave, pajisjeve të punës dhe instrumenteve matëse e kontrolluese në një servis për shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së veglave, pajisjeve të punës dhe instrumenteve matëse në një servis për shërbimet xhenerike;
- Të listojë materialet kryesore që shërbejnë për pastrim dhe mirëmbajtjen e veglave të punës.

Kontrollet paraprake të pjesëve xhenerike të mjeteve transportit

Të përgjithshme

- Të përshkruajë rëndësinë e kontrolleve paraprake të pjesëve xhenerike;
- Të listojë llojet dhe procedurat e kontrolleve paraprake të pjesëve xhenerike;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet në pjesët xhenerike duke përdorur mjetet përkatëse;
- Të krahasojë vlerat e matura me referencat e manualit të prodhuesit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit (lokalizimi) të parregullsisë në pjesën xhenerike;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të zgjedhjes më ekonomike dhe ekologjike të riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e vendosjes së mjetit në urën e kontrollit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të lidhjeve elektrike dhe hidraulike në shërbimet xhenerike.

Në sistemin e transmetimit të fuqisë

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tipeve të ndryshme të friksioneve mekanike/hidraulike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të mekanizmave të komandimit të friksioneve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tipeve të ndryshme të kutive të ndërrimit të shpejtësisë manuale, gjysmëautomatike dhe automatike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të transmisioneve kardanike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të transmisionit kryesor dhe diferencialit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të boshteve dhe gjysmëboshteve të transmetimit.

Në sistemin e frenimit

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementëve të sistemeve të ndryshme të frenimit (mekanik, hidraulik, me ajër, elektrik, etj);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të depresorit, disqeve të frenave, tambureve, ferrodave, pistonçinave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tubacioneve metalike dhe prej gome të alkoolit si dhe rekorderive të lidhura me to;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gjendjes dhe nivelit të alkoolit të frenave.

Në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tipeve të ndryshme të strukturave mbajtëse, shasive etj.;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gominave të peshave të agregatëve të mbështetura në shasi;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tipeve të ndryshme të urave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të krahëve dhe gominave në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të tipeve të ndryshme të amortizatorëve;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të jastëkëve të ajrit dhe

- suporteve e tyre;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të fijeve/grupit të balestrave.

Në sistemin e drejtimit

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të elementëve përbërës të sistemit të drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të grupit të timonit dhe sistemit të levave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të përforcuesit hidraulik/elektrik të grupit të timonit.

Në sistemin e ecjes

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të funksionimit të elementëve të sistemit të ecjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të balancimit statik dhe dinamik të rrotave;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave.

Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në pjesët xhenerike

Të përgjithshme

- Të listojë llojet e punimeve në pjesët xhenerike;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve sipas manualeve të prodhuesit për punimet xhenerike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e çmontim/montimit të elementeve përbërës të pjesëve xhenerike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve përbërës të pjesëve xhenerike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e riparimit me ngjitje, bashkim dhe saldim, me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e riparimit me axhustim, me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të përshkruajë proceset e punës së regjistrimeve sipas karakteristikave teknike në shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të manualeve të prodhuesit për lubrifikuesit që përdoren në shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë procedurat e shkëputjes dhe rivendosjes së lidhjeve elektrike në shërbimet xhenerike;
- Të përshkruajë procedurat e përzgjedhjes së pjesëve, materialeve për zëvendësim.

Në sistemin e transmetimit të fuqisë

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tipet e ndryshme të friksioneve mekanike;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tipet e ndryshme të friksioneve

hidraulikë;

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mekanizmat e komandimit të friksioneve;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tipet e ndryshme të kutive manuale të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tipet e ndryshme të kutive automatike dhe gjysmë automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në bashkueset (xhuntot) kardanike të boshteve të transmisionit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në transmisionin kryesor;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në diferencial;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në boshtet dhe gjysmëboshtet e transmetimit;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit të mjetit të transportit pas punimeve të kryera.

Në sistemin e frenimit

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të frenimit mekanik (frenat e dorës);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të frenimit hidraulik;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të frenimit pneumatik;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në disqet e frenave, tamburëve, ferrodave, pistonçinave etj.;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tubacionet metalike dhe prej gome të alkoolit, si dhe rekorderive të lidhura me to;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në depresorin e frenave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për ndërrimin e alkoolit të frenave;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit të mjetit të transportit pas punimeve të kryera.

Në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementet e sistemit të shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në strukturat mbajtëse e shasi;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat e peshave të agregateve të mbështetura në shasi;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në tipet e ndryshme të urave (aktive, të kombinuara, përparme drejtuese, pasive mbajtëse);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat e urës së parë e të pasme;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat mbështetëse të kabinës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat dhe krahët e stabilizatorit të parë e të pasmë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat e krahëve lëkundës (shpatullave);
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në varëset (sospensionet);

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në amortizatorët e parë e të pasmë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gominat dhe kushinetat e suporteve të amortizatorëve të parë e të pasmë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në jastëkët e ajrit dhe suporteve të tyre;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në sustat dhe gominat mbajtëse të tyre;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në fijet/grupet e balestrave dhe gominave të suporteve mbajtëse të tyre;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit të mjetit të transportit pas punimeve të kryera.

Në sistemin e drejtimit

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të drejtimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e grupit të timonit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mekanizmin e kthimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në lidhjet e levës (levave) me krahun (krahët) e mekanizmit të kthimit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në lidhjet e krahut (krahëve) të mekanizmit të kthimit me levën (levat) e kthimit të rrotave;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në përforcuesit elektrikë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në përforcuesit hidraulikë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në kokat sferike të krahëve lëkundës të parë e të pasmë;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit të mjetit të transportit pas punimeve të kryera.

Në sistemin e ecjes

- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në elementët e sistemit të ecjes;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në disk;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në gomë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve për procesin e balancimit statik dhe dinamik të rrotës;
- Të përshkruajë procedurat dhe mënyrat e punimeve në mocot dhe kushinetat e rrotës;
- Të shpjegojë procedurat dhe mënyrat e punimeve për korrigjimin e gjeometrisë (konvergencës) së rrotave;
- Të shpjegojë procedurën e ndjekur për provën e funksionimit të mjetit të transportit pas punimeve të kryera.

Shërbime mirëmbajtjeje të pjesëve xhenerike

- Të listojë llojet e shërbime të mirëmbajtjes të pjesëve xhenerike;
- Të listojë llojet e mirëmbajtjeve periodike të pjesëve xhenerike;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes së pjesëve xhenerike duke argumentuar rëndësinë e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së informacioni nga manualët e prodhuesit për

shërbimet e mirëmbajtjes;

- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të informacionit të marrë nga burime të ndryshme për shërbimet e mirëmbajtjes;
- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes të elementëve të sistemeve dhe mekanizmave në pjesët xhenerike
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve periodike në mirëmbajtjen e pjesëve dhe sistemeve xhenerike në varësi të përdorimit (km, orë pune, etj.)
- Të përshkruajë llojet e pastrimeve, mënyrat dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në shtrëngimin e pjesëve xhenerike sipas kushteve teknike;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në grasatimin/lubrifikimin e pjesëve xhenerike sipas kushteve teknike;
- Të listojë llojet e fluidët/lubrifikuesit që përdoren në mirëmbajtjen e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në friksionin mekanik;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në friksionin hidraulik;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në mekanizmat e komandimit të friksioneve;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në kutitë manuale të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në kutitë automatike dhe gjysmë automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes të transmisioneve kardanike;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes të transmisionit kryesor dhe diferencialit;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes të boshteve dhe gjysmëboshteve të transmetimit;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit e frenimit;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të drejtimit;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në përforcuesit hidraulikë/elektrik;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të përshkruajë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të ecjes;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e plotësimit të dokumentacionit të shërbimeve të mirëmbajtjes.

Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të shpjegojë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të listojë llojet e dixhitalizimit të pagesave dhe ndikimin që sjellin në zhvillimin e aktivitetit;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të çmimit të tregut lidhur me materialet, pajisjet e

- punës dhe pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të përshkruajë llogaritjet e kostos së materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të shpjegojë mënyrat e furnizimit me bazë materialeve dhe pajisje të nevojshme;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet e kryera në pjesët xhenerike;
- Të përshkruajë mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit teknik dhe financiar të punimeve të kryera te klienti;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për shërbimet xhenerike në mjetet e transportit.

Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas standardeve në fuqi;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetin në punë;
- Të listojë llojet e aksidenteve kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve xhenerike si dhe mënyrat e shmangies së tyre;
- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH).
- Të përshkruajë rreziqet nga zjarri, që vijnë nga ambientet me gaz, nga energjia elektrike, nga materialet ndezëse (shkrepëse, çakmakë, etj.);
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me vegla dhe pajisje nën tension;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme, etj.;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materiale të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, solucionet kimike etj.);
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të përshkruajë procedurat dhe mjetet e dhënies së ndihmës së shpejtë;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;

- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, veglave të këmbimit dhe të energjisë;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
- Të përshkruajë llojet e tabelave të sigurisë teknike;
- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të TIK dhe teknologjive të reja të komunikimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të këmbëjë udhëzime/procedura me kolegët për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
- Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët, si zgjidhjes së konflikteve;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;
- Të përshkruajë Kodin e Etikës, rëndësinë e zbatimit të tij;
- Të përshkruajë mënyrat e regjistrimit të ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
- Të përshkruajë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e nevojës për trajnime të vazhdueshme dhe aplikimeve të teknologjive/ teknologjive të reja në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Shërbime xhenerike” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të jetë i aftë:

Organizimi dhe përgatitja e vendit të punës në shërbimet e xhenerike

- Të organizojë vendin e punës për shërbimet xhenerike të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë standardet e profesionit të xhenerikut;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik për punimet xhenerike;
- Të konsultohet me teknikët e grupet e tjera të punës;
- Të zbatojë mënyrën e planifikimit, organizimit dhe monitorimit të veprimtarisë;
- Të zbatojë veprimtaritë sipas planifikimit ditor, mujor, etj. dhe prioriteteve;
- Të sigurojë bazën materialo-teknike për shërbimet xhenerike;
- Të përzgjedhë materialet që përdoren në shërbimet xhenerike sipas përdorimit të tyre;
- Të zbatojë procedurat për vendosjen e mjetit në vendin e kontrollit për shërbimet xhenerike;
- Të zbatojë procedurat/rregullat për pranimin e mjetit për kontroll paraprak;

- Të zbatojë rregullat e kontrollit dhe sigurimit të gjendjes teknike të mjeteve dhe pajisjeve të punës në shërbimet xhenerike;
- Të hartojë një preventiv punimi me elementët përbërës, duke kryer llogaritjet përkatëse;
- Të zbatojë radhën e punës dhe fazat e realizimit të punimit;
- Të kryejë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës pas çdo procesi pune.

Veglat, pajisjet, makineritë e punës dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese në shërbimet xhenerike

- Të përzgjedhë veglat, pajisjet e punës, makineritë dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese sipas funksionit të tyre;
- Të përdorë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet xhenerike, sipas manualit të prodhuesit;
- Të përzgjedhë materialet e duhura për pastrimin dhe mirëmbajtjen e veglave, të pajisjeve të punës dhe instrumentet matëse.
- Të mirëmbajë veglat, pajisjet e punës dhe instrumentet matëse në një servis për shërbimet xhenerike;
- Të zbatojë manualet e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve ndihmëse në një servis për shërbimet xhenerike.

KONTROLLET PARAPRAKE NË MJETET E TRANSPORTIT

Të përgjithshme

- Të kryejë kontrollet paraprake të pjesëve xhenerike;
- Të përdorë dokumentacionin teknik të automjetit sipas manualeve të prodhuesit;
- Të zbatojë procedurat e kontrolleve paraprake të pjesëve xhenerike në mjetet e transportit, duke përdorur pajisjet përkatëse;
- Të kryejë matjet, dhe kontrollet me anën e pajisjeve përkatëse, në pjesët xhenerike;
- Të interpretojë vlerat e matura me referencat e manualit të prodhuesit;
- Të përcaktojë (lokalizojë) parregullsitë në pjesët xhenerike;
- Të zgjedhë mënyrën më ekonomike dhe ekologjike të riparimit;
- Të zbatojë procedurat e vendosjes së mjetit në urën e kontrollit;
- Të kryejë kontrollet paraprake të lidhjeve elektrike dhe hidraulike në shërbimet xhenerike.

Në sistemin e transmetimit të fuqisë

- Të realizojë kontrollin e elementëve të sistemit të transmetimit të fuqisë;
- Të realizojë kontrollin e elementëve të friksioneve mekanike/hidraulike;
- Të realizojë kontrollin e elementëve të mekanizmave të komandimit të friksioneve;
- Të realizojë kontrollin paraprak të tipeve të ndryshme të kutive të ndërrimit të shpejtësisë manuale, gjysmë automatike dhe automatike;
- Të realizojë kontrollin e elementëve të mekanizmave të komandimit të kutive manuale, automatike dhe gjysmë automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë kontrollin paraprak të transmisioneve kardanike;
- Të realizojë kontrollin paraprak të transmisionit kryesor;
- Të realizojë kontrollin paraprak të diferencialit;
- Të realizojë kontrollin e boshteve dhe gjysmëboshteve të transmetimit.

Në sistemin e frenimit

- Të realizojë kontrollin e elementëve të sistemeve të ndryshme të frenimit (mekanik, hidraulik, me ajër, elektrik, etj);
- Të realizojë kontrollin e depresorit, disqeve të frenave, tambureve, ferrodave, pistonçinave;
- Të realizojë kontrollin e tubacioneve metalike dhe prej gome të alkoolit si dhe rekorderive të lidhura me to;
- Të realizojë kontrollin e gjendjes dhe nivelit të alkoolit të frenave.

Në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes

- Të realizojë kontrollin e tipeve të ndryshme të strukturave mbajtëse, shasive, etj;
- Të realizojë kontrollin e gominave të peshave të agregatëve të mbështetura në shasi;
- Të realizojë kontrollin e tipeve të ndryshme të urave;
- Të realizojë kontrollin e krahëve dhe gominave në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të realizojë kontrollin e tipeve të ndryshme të amortizatorëve;
- Të realizojë kontrollin e jastëkëve të ajrit dhe suporteve e tyre;
- Të realizojë kontrollin e fijeve/grupit të balestrave.

Në sistemin e drejtimit

- Të realizojë kontrollin e elementëve përbërës të sistemit të drejtimit;
- Të realizojë kontrollin e grupit të timonit dhe të levave;
- Të realizojë kontrollin e përforcuesit hidraulik/elektrik të grupit të timonit.

Në sistemin e ecjes

- Të realizojë kontrollin e elementëve të sistemit të ecjes;
- Të realizojë kontrollin e balancimit statik dhe dinamik të rrotave;
- Të realizojë kontrollin e mocos dhe të kushinetës së rrotës;
- Të realizojë kontrollin e gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave.

Punime (çmontim/montimi, riparimi dhe/ose zëvendësimi) në pjesët xhenerike të mjeteve të transportit

Të përgjithshme

- Të realizojë punime në pjesët xhenerike;
- Të zbatojë standardet sipas manualeve të prodhuesit për punimet xhenerike;
- Të realizojë procedurat dhe mënyrat e çmontim/montimit të elementeve përbërës të pjesëve xhenerike;
- Të realizojë procedurat dhe mënyrat e zëvendësimit të elementeve përbërës të pjesëve xhenerike;
- Të realizojë procedurat dhe mënyrat e riparimit me ngjitje, bashkim dhe saldim, me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të realizojë procedurat dhe mënyrat e riparimit me axhustim, me pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- Të realizojë proceset e punës së regjistrimeve sipas karakteristikave teknike në shërbimet xhenerike;
- Të zbatojë udhëzimet e manualeve të prodhuesit për fluidët/ lubrifikuesit që përdoren

në shërbimet xhenerike;

- Të realizojë procedurat e shkëputjes dhe rivendosjes së lidhjeve elektrike;
- Të përzgjedhë pjesët, materialet për zëvendësim;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet xhenerike sipas specifikimeve teknike të duhura,

Në sistemin e transmetimit të fuqisë

- Të realizojë punime në elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë;
- Të realizojë punime në elementët e friksioneve mekanike;
- Të realizojë punime në elementët e friksioneve hidraulike;
- Të realizojë punime në mekanizmat e komandimit të friksioneve;
- Të realizojë punime në tipet e ndryshme të kutive manuale të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë punime në tipet e ndryshme të kutive gjysmëautomatike dhe automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë punime në mekanizmat e komandimit të kutive manuale, automatike dhe gjysmë automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë punime në elementët e transmisioneve kardanike;
- Të realizojë punime në transmisionin kryesor;
- Të realizojë punime në diferencial;
- Të realizojë punime në boshtet dhe gjysmëboshtet e transmetimit;
- Të realizojë provën e funksionimit të punimeve të kryera.

Në sistemin e frenimit

- Të realizojë punime në elementët e sistemit të frenimit;
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të frenimit mekanik (frenat e dorës);
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të frenimit hidraulik;
- Të realizojë punime në elementët e sistemit të frenimit pneumatik;
- Të realizojë punime në disqet e frenave, tamburëve, ferrodave, pistonçinave (cilindrave);
- Të realizojë punimet në depresorin e frenave;
- Të realizojë punime në tubacionet metalike dhe prej gome të alkoolit si dhe rekorderive të lidhura me to;
- Të realizojë punimet për ndërrimin e alkoolit të frenave;
- Të realizojë punime në elementë të sistemeve të frenimit, të ndryshme nga ato të përshkruara më sipër;
- Të realizojë provën e funksionimit të punimeve të kryera.

Në sistemin e shuarjes së lëkundjeve dhe varjes

- Të realizojë punime në elementet e sistemit të shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të realizojë punime në strukturat mbajtëse dhe në shasi;
- Të realizojë punime në gominat e peshave të agregateve të mbështetura në shasi;
- Të realizojë punime në tipet e ndryshme të urave (aktive, të kombinuara, përparme drejtuese, pasive mbajtëse);
- Të realizojë punime në gominat e urës së parë e të pasme;
- Të realizojë punime në gominat mbështetëse të kabinës;

- Të realizojë punime në gominat dhe krahët e stabilizatorit të parë e të pasmë;
- Të realizojë punime në gominat e krahëve lëkundës (shpatullave) ;
- Të realizojë punime në varëset (suspensionet);
- Të realizojë punime në amortizatorët e parë e të pasmë;
- Të realizojë punime në gominat dhe kushinetat e suporteve të amortizatorëve të parë e të pasmë;
- Të realizojë punime në jastëkët e ajrit dhe suporteve të tyre;
- Të realizojë punime në sustat dhe gominat mbajtëse të tyre;
- Të realizojë punime në fijet/grupet e balestrave dhe gominave të suporteve mbajtëse të tyre;
- Të realizojë provën e funksionimit të punimeve të kryera.

Në sistemin e drejtimit

- Të realizojë punime në elementët e sistemit të drejtimit;
- Të realizojë punime në elementët e grupit të timonit;
- Të realizojë punime në elementët e përforcuesve hidraulikë të sistemit të drejtimit;
- Të realizojë punime në elementët e përforcuesve elektrikë të sistemit të drejtimit;
- Të realizojë punime në lidhjet e levës (levave) me krahun (krahët) e mekanizmit të kthimit;
- Të realizojë punime në lidhjet e krahut (krahëve) të mekanizmit të kthimit me levën (levat) e kthimit të rrotave;
- Të realizojë punime në kokat sferike të krahëve lëkundës të parë e të pasmë;
- Të realizojë provën e funksionimit të punimeve të kryera.

Në sistemin e ecjes

- Të realizojë punime në elementët e sistemit të ecjes;
- Të realizojë punime në disk;
- Të realizojë punime në gomë;
- Të realizojë punime për balancimin statik dhe dinamik të rrotës;
- Të realizojë punime në mocot dhe kushinetat e rrotës;
- Të realizojë punime për korrigjimin e gjeometrisë (konvergjencës) së rrotave;
- Të realizojë provën e funksionimit të punimeve të kryera.

Shërbime mirëmbajtjeje të pjesëve xhenerike të mjeteve të transportit

- Të realizojë llojet e shërbime të mirëmbajtjes të pjesëve xhenerike;
- Të realizojë llojet e mirëmbajtjeve periodike të pjesëve xhenerike;
- Të zbatojë informacionin e marrë nga manualët e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes;
- Të përdorë informacioni nga burime të ndryshme për shërbimet e mirëmbajtjes në pjesët xhenerike;
- Të kryejë mirëmbajtjen e elementëve të sistemeve dhe mekanizmave të pjesëve xhenerike;
- Të realizojë shërbimeve periodike në mirëmbajtjen e pjesëve dhe sistemeve xhenerike në varësi të përdorimit (km, orë pune, etj.)
- Të kryejë pastrime në pjesët e grupeve xhenerike me mjetet e nevojshme;

- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në shtrëngimin e pjesëve xhenerike sipas kushteve teknike;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në grasatimin/lubrifikimin e pjesëve xhenerike sipas kushteve teknike
- Të përcaktojë llojet e fluidët/lubrifikuesit që përdoren në mirëmbajtjen e mjeteve të transportit;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në friksionin mekanik;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në friksionin hidraulik;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në mekanizmat e komandimit të friksioneve;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në kutitë manuale të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në kutitë automatike dhe gjysëm automatike të ndërrimit të shpejtësisë;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes të transmisioneve kardanike;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes të transmisionit kryesor dhe diferencialit;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes të boshteve dhe gjysmëboshteve të transmetimit;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit e frenimit;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të drejtimit;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në përforcuesit hidraulikë;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të shuarjes së lëkundjeve dhe varjes;
- Të realizojë shërbimet e mirëmbajtjes në elementet e sistemit të ecjes.

Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës

- Të hartojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të kryejë detyrimet tatimore, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën që lidhet me aktivitetin e kryer;
- Të hartojë raportet periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të përgatisë regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të përcaktojë llojet e dixhitalizimit të pagesave dhe ndikimin që sjellin në zhvillimin e aktivitetit;
- Të përcaktojë ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit;
- Të analizojë kontrollin e çmimit të tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës dhe pjesët e këmbimit si dhe shërbimeve të kryera;
- Të llogarisë koston e materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të përgatisë oferta për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të kryejë furnizimin me bazë materialeve dhe pajisje të nevojshme;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera në pjesët xhenerike
- Të kryejë dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe financiar për punimet e kryera të klienti.

Rregullat e sigurisë, shëndetit në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në shërbimet xhenerike në mjetet e transportit;
- Të zbatojë rregullat për shmangien e aksidenteve kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve xhenerike të mjeteve të transportit;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) të vendosura në mjediset e punës;
- Të sigurojë dhe mbajë uniformën e përshtatshme për punë;
- Të zbatojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të kutisë së Mbrojtje nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);
- Të përdorë mjetet zjarrfikëse kur është nevoja;
- Të zbatojë rregullat për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, kur punohet në ambientet me gaz, me energji elektrike, me materialet ndezëse (shkrepëse, çakmakë, etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me energji elektrike; Të kontrollojë tokëzimin e pajisjeve elektrike;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave dhe peshave të rënda (të sigurojë vendosjen e mjetit mbi urën ngritëse, të sigurojë vendosjen e nyjeve të çmontuara në bango);
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme, etj;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes, magazinimit dhe sigurisë në punë, gjatë punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, solucionet kimike etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
- Të zbatojë procedurat e dhënies së ndihmës së shpejtë në rast aksidenti;
- Të kryejë procedurat e duhura për ndarjen e mbeturinave sipas llojit dhe depozitimin e mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të zbatojë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve, sipas rregullave përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Të zbatojë përdorimin në mënyrë racionale të lëndëve të para, veglave të këmbimit dhe të energjisë, duke bërë edhe riciklimin e tyre;
- Të zbatojë masat përkatëse për eliminimin e ndotjes së mjedisit;
- Të zbatojë tabelat e sigurisë teknike dhe rrethimin e objektit
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të komunikojë me kolegët dhe drejtuesit në ambientin e punës;
- Të përdorë teknologjitë e reja të komunikimit, duke përfshirë TIK;
- Të shkëmbejë me kolegët informacione mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë udhëzimet/procedurat për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të zbatojë hierarkinë dhe rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale gjatë komunikimit me kolegët dhe klientët;

- Të zbatojë Kodin e Etikës në komunikimin/ sjelljen me kolegët, drejtuesit, klientët, si dhe në paraqitjen e jashtme në vendin e punës;
- Të kryejë regjistrimin e ankesave të klientëve;
- Të komunikojë me etikë profesionale për zgjidhjen e konflikteve;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;
- Të kryejë trajnime të vazhdueshme sipas nevojës për rritje profesionale;
- Të analizojë të dhënat e performancës së kolegëve dhe njësisë ku ai punon;
- Të përditësojë njohuritë për të aplikuar teknikat/ teknologjitë e reja në punë;
- Të realizojë veprimtaritë e zhvillimit profesional të vazhduar, bazuar në vetëvlerësim ose vlerësimin e performancës nga drejtuesi i tij;
- Të marrë pjesë në trajnimet e ndryshme të sigurisë dhe rrisë kualifikimin tij në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit.
- Të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efeciente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.